



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.12.2019)

Pika 1 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

1 (Pikë shtesë). Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}”.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Siç jeni njoftuar, sot do zhvillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 4 dhjetor 2019. Të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, siç ju kam njoftuar lidhur me rendin e ditës, sot në rend të ditës ishte vetëm një çështje që ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, por me kërkesë të dy kryetarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i propozohet mbledhjes të futen në rend të ditës edhe 2 çështje të tjera. E para ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}. Dhe çështja e dytë që i propozohet mbledhjes plenare për t’u futur në rend dite është lidhur me refuzimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për dhënien e lejes së papaguar.

Nga ana tjetër, unë në cilësinë e Kryetares, duke parë eventualitetin e situatës së ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore në të gjithë gjykatat e qarkut, për të cilat ne i kemi pezulluar, propozoj gjithashtu edhe një çështje tjetër në rend të ditës, që ka të bëjë me rifillimin e veprimtarisë së shërbimeve në një pjesë të gjykatave që ne i kemi pezulluar.

Atëherë, nëse jemi dakord me shtimin e këtyre tre çështjeve në rend të ditës, ju lutem kalojmë në votimin e tyre?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, po fillojmë fillimisht me çështjen e parë që ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}. Ky projekt-akt do të propozohet, do të relatohet nga zonja Shehu. Fjalën e ka zonja Shehu!

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Paraqesim përpara jush projekt-aktin, projektvendimin dhe relacionin përkatës lidhur me kërkesën e paraqitur dhe deklarin e paraqitur nga gjyqtari {...}, gjyqtar i apelit Tiranë, me anë të së cilës ai deklaroi heqjen dorë nga statusi i magjistratit.

Rezulton se zoti {...} ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës më datë 26.03.94. Pas marrjes së titullit “Jurist”, me vendimin nr. 5, datë 01.07.94 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më pas, me vendimin 229/A, datë 21.04.2008 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri kur me dekretin 6570, datë 19.05.2010 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku vijon të ushtrojë edhe detyrën aktualisht.

Me shkresën nr. 4997 prot., datë 10.10.2019, gjyqtari {...} ka paraqitur një deklarin përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, me objekt: Deklarimin e dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë; Deklarimin e dorëheqjes nga funksionet e

magjistratit në Republikën e Shqipërisë; Kërkesë për deklarinim prej Këshillit të Lartë Gjyqësor të mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes. Si shkak i paraqitjes së kësaj dorëheqjeje, zoti {...} ka parashtruar gjendjen e rënduar shëndetësore, ku sipas tij është rekomanduar nga mjekët mbajtja nën kontroll dhe vizita të rregullta, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e ndërhyrjes kirurgjikale.

Në nenin 64 dhe 65 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kemi edhe situatën ligjore se kur mbaron statusi i magjistratit. Në nenin 64/1/a, një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit është pikërisht edhe rasti kur magjistrati jep dorëheqjen. Ndërsa në nenin 95, në nenin 65, - më falni, -po të këtij ligji, rregullohet në mënyrë specifike edhe dorëheqja si një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit.

Bazuar sa më sipër, në të gjithë rrethanat e faktit si dhe në situatën ligjore, pra bazuar në nenin 64-65 të ligjit 96/2016 Komisioni vlerëson se në rastin konkret jemi në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit {...}, për shkak të dorëheqjes së paraqitur prej tij përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo dorëheqje i ka krijuar efektet ligjore më datë 30.11.2019, pra në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli ka marrë deklarinim me shkrim të dorëheqjes më datë 10.10.2019.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarit {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit. Efektet ligjore të dorëheqjes fillojnë më datë 30.11.2019. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status. 2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.11.2019. 3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.12.2019)

Pika 2 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtarës znj. {...} për dhënie leje të papaguar”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

2 (Pikë shtesë). Shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...} për dhënie leje të papaguar”.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit lidhur me refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënien e lejes së papaguar, projekt-akt i cili do të relatohet nga zonja Brikena Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Lidhur me shkaqet e nisjes së procedurës administrative nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatoj se në datën 18.11.2019 zonja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka paraqitur një kërkesë për leje të papaguar për arsye familjare. Në kërkesën me shkrim, zonja {...} parashtron se është nënë e fëmijës së mitur {...}. i moshës 10 muajsh, i cili ka lindur në shtetin italian dhe prej dy javësh është kthyer në Shqipëri me qëllim që fëmija të ambientehej dhe ajo të fillonte punën në datën 07.12.2019, pas përfundimit të lejes së lindjes. Gjyqtarja ka parashtruar se e ka të pamundur për t’u kthyer në punë, pavarësisht dëshirës për të ushtruar profesionin, me arsyetimin se fëmija i saj i mitur ka patur probleme të stresit, rënies së imunitetit, shenja ankthi, për shkak se është ende duke u ushqyer me gji dhe përpjekjet e saj për ta çuar në çerdhe apo për ta lënë nën kujdesin e një dadoje kanë dështuar.

Për këto arsye, duke parashtruar se si prind duhet t'i japë prioritet mirëqenies psiko-fizike të foshnjës, gjyqtarja {...} ka kërkuar dhënien e lejes së papaguar për periudhën 07.12.2019 – 30.04.2020, duke kërkuar mirëkuptimin e Këshillit për mbajtjen parasysh të interesit më lart të fëmijës.

Duke qenë përpara një kërkesë për leje të papaguar, Komisioni zhvilloi procedurën administrative brenda 7 ditëve nga depozitimi i kërkesës dhe në mbledhjen e datës 25.11.2019 vendosi që këtë vendimmarrjen e tij bashkë me relacionin përkatës t'ia parashtrojë për shqyrtim mbledhjes plenare. Për shkak të situatave emergjente, duke qenë se mbledhja plenare e datës 27 e planifikuar për t'u zhvilluar nuk u zhvillua, në mbledhjen më të hershme që Këshilli zhvilloi, u propozua që të merrej në shqyrtim edhe kjo kërkesë, për arsye sepse në datën 07.12. gjyqtarja duhet të fillojë normalisht punën.

Lidhur me çështjet të statusit profesional që gjyqtarës {...}, nga verifikimet e dosjes së saj personale, rezulton se ajo është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 128 të datës 19.07.2019 dhe mandej me vendimin nr. 147 të datës 30.07.2019 ajo është caktuar në pozicionin e gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Ajo nuk e ka ushtruar efektivisht detyrën e gjyqtarës sepse ka qenë me raport leje pas lindjeje, i fundit i depozituar në gjykatë, sipas informacionit të përcjellë nga kancelarja e gjykatës, i përket periudhës 01.11.2019 – 01.12.2019. Në këto rrethana, zonja {...} nuk ka më shumë se 1 vit pune të pandërprerë si gjyqtare.

Në lidhje me funksionalitetin e gjykatës - Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, aktualisht funksionon vetëm me 1 gjyqtar, zotin {...}, i cili është i transferuar përkohësisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Lidhur me ngarkesën aktuale të kësaj gjykate - Nga informacioni i përcjellë nga zëvendëskryetari i gjykatës më datë 25.11.2019, rezulton se nr. i çështjeve të regjistruara për periudhën 01.01.2019 – 22.11.2019 është 920 çështje. Nr. i çështjeve të pa shortuara është 823 çështje, nga të cilat 424 çështje të ardhura në periudhën 14.06.2019 – 22.11.2019 dhe 399 çështje të tjera të cilat janë dorëzuar nga gjyqtarja {...} (gjyqtarja e pezulluar për shkak të procesit të rivlerësimit), të cilat nuk janë të shortuara, ndërsa nr. i çështjeve që ka në shqyrtim vet gjyqtari {...} është 348 çështje. Në këto kushte, plotësimi i trupës gjyqësore të kësaj gjykate kërkon ndërhyrjen urgjente të Këshillit.

Lidhur me kuadrin ligjor të zbatueshëm, për sa i përket lejeve të papaguara, neni 24 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se magjistrati mund të përfitojë leje prindërore ose edhe pushime të tjera. Në këtë dispozitë parashikohet që Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së papaguar dhe në bazë të kësaj dispozite është vetë Këshilli që ka miratuar vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në të cilin përcaktohen kriteret dhe procedurat se si jepen këto leje.

Për sa i përket llojeve të lejeve, në vendim janë rregulluar procedura dhe kriteret për lejen prindërore, për lejen për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi dhe leje për arsye familjare dhe/ose shëndetësore.

Në kërkesën e zonjës {...} parashtrohet se kërkesa për leje të papaguar kërkohet për arsye familjare por referuar përmbajtjes së kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, Komisioni ka konstatuar që leja në fakt kërkohet për përkujdesje për fëmijën e mitur dhe për këtë arsye, Komisioni ka analizuar paraprakisht pretendimet e gjyqtares referuar të dy llojeve të lejeve të papaguara: si asaj prindërore, ashtu edhe asaj familjare.

Lidhur me kushtet e lejes prindërore, referuar dispozitave ligjore, dispozitave të Kodit të Punës por edhe atyre të rregullores, është parashikuar që leja prindërore ka kushtin e parë kumulativ “detyrueshmërinë e gjyqtarit për të ushtruar funksionin në gjykatë më shumë se 1 vit të pandërprerë” dhe mandej vazhdojnë kushtet e tjera.

Ndërsa për sa i përket kushteve për dhënien e lejes për arsye familjare, referuar vendimmarrjes së Këshillit dhe rregullores përkatëse është parashikuar që kjo leje mund të jepet për një periudhë nga 30 ditë deri në 2 vjet në kushtet e mëposhtme: gjyqtari duhet të paraqesë kërkesë me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë përpara kohës kur ai kërkon të fillojë kjo leje; në rast të nevojave urgjente kërkesa mund të paraqitet menjëherë pa vonesë; kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyeve dhe afatin e lejes së kërkuar; duhet t'i bashkëngjitet kërkesës dokumentacioni justifikues dhe mendimi me shkrim nga kryetari i gjykatës, në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit. Mandej në rregullore është parashikuar gjithë procedura se si shqyrtohet nga Komisioni dhe nga mbledhja plenare kjo leje dhe, në pikën /d/, në shkronjën /d/ të pikës VII të rregullores,

parashikohet shprehimisht: “Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, për arsye familjare, sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.”

Bazuar në këto rrethana fakti dhe në këtë kuadër ligjor të sipërcituar, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson se, në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, gjyqtarja {...} nuk ka ushtruar detyrën për të paktën 1 vit në mënyrë të pandërprerë, kusht kumulativ i detyruar i parashikuar në nenin 132, pika 1 e Kodit të Punës dhe pika V e rregullores së Këshillit. Për këtë arsye ajo nuk mund të përfitojë leje prindërore.

Së dyti, dokumentacioni nuk plotëson edhe kushtet formale të parashikuara në rregullore, pasi aktet provuese janë në gjuhë të huaj, të pa përkthyer, mungon mendimi me shkrim i kryetarit, në rastin konkret të zëvendëskryetarit të gjykatës pranë të cilës gjyqtarja është caktuar në mënyrë të përhershme. Gjithsesi Komisioni kryesisht i kërkoi informacion kryetarit lidhur me situatën faktike të funksionalitetit të gjykatës.

Së treti, kërkesa është e pabazuar në thelb sepse referuar pretendimit për leje për arsye familjare dhe ngarkesës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, numrit të çështjeve të pa shortuara, funksionimit të saj me një gjyqtar, aq më tepër që ky gjyqtar është gjyqtar i transferuar nga një gjykatë tjetër, dëmtohet funksionaliteti i saj. Vijimi i funksionimit të gjykatës vetëm me një gjyqtar, ndërkohë që rezultojnë ende 823 çështje të pa shortuara dhe një ngarkesë e përgjithshme prej 920 çështjesh krijon një situatë tepër të vështirë për funksionimin e gjykatës dhe krijon vonesa në trajtimin e çështjes dhe zgjidhjen e tyre në kohë dhe sipas afateve ligjore. Përgjegjësia e Këshillit është jo vetëm plotësimi i trupave gjyqësore me qëllim funksionalitetin e gjykatave por edhe marrja e masave që nuk dëmtojnë efektivitetin dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë. Prandaj, miratimi i lejes për arsye familjare nga ana e Komisionit është vlerësuar jo proporcional me nevojat e veçanta që lidhen me këto të parashtruara nga gjyqtarja dhe me mirëfunksionimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Kërkesa e gjyqtares është trajtuar edhe në kuadrin kushtetues të cenimit apo jo të

interesit më të lartë të fëmijës referuar dispozitave të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se interesi më i lartë i fëmijës ka përparësi në të gjitha çështjet që lidhen me të. Është relatuar edhe herë tjetër që në kuadër të garantimit dhe mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës të sanksionuar në Kushtetutë, ligjvënësi me qëllim për afrimin e legjislacionit në direktivat e BE-së, me ligjin 136 të vitit 2015 ka parashikuar lejen prindërore si një të drejtë vetjake të pa transferueshme të punëmarrësit që nuk mund të refuzohet nga punëdhënësi, nëse punëmarrësi plotëson kushtet e dispozitës dhe që duhet konceptuar si mundësi e prindit për t'iu përkushtuar në kohë fëmijës. Sigurisht që të drejtën e përfitimit të lejes prindërore ka edhe çdo gjyqtar që plotëson të njëjtat kriteret të vendosura në Kodin e Punës, por siç u realizua më lart, gjyqtarja në këtë rast nuk mund ta përfitojë sepse nuk ka 1 vit pune të pandërprerë. Nga ana tjetër përfitimi i kësaj lejeje vërtetë cenon funksionalitetin e gjykatës por nga ana tjetër nuk garanton një trajtim të barabartë jo vetëm të grave gjyqtare por edhe të gjithë nënave në Republikën e Shqipërinë sepse në rast të kundërt do ishim para një diskriminimi në kuadër ku shteti përveç lejes së lindjes garanton mirëqenien fiziko-psikike të fëmijëve nëpërmjet institucioneve të veçanta ku fëmijët mund të lihen përgjatë kohës që nëna është në orar pune. Nga ana tjetër edhe vetë ligji i statusit të gjyqtarit garanton uljen e ngarkesës së gjyqtarit, reduktimin e orëve të punës në rast se ai është duke ushqyer fëmijën, sipas dispozitave të veçanta që paraqet ligji për Statusin, por që nuk përlligjin në këtë rast dhënien e një leje të papaguar.

Për sa u relatua, Komisioni propozon refuzimin e kërkesës së zonjës {...} për dhënien e lejes së papaguar për periudhën 7 dhjetor 2019 – 30 prill 2020.

Lidhur me kompetencën e mbledhjes plenare, dua të sjellë në vëmendje të Këshillit që në kohën kur u miratua rregullorja për lejet e papaguara, neni 61 i ligjit “Për organet e qeverisjes” nuk kishte ndryshuar, pra ishte dispozitë e shfuqizuar dhe ne deri në atë kohë, kompetencën për çdo vendimmarrje ia kishim kaluar mbledhjes plenare. Në këtë logjikë, gjithashtu në momentin kur u relatua rregullorja, duke qenë se bëhej fjalë për leje dyvjeçare, menduam që do të ishte disponim i mbledhjes dhe jo i Komisionit. Aktualisht, neni 61 i ka të përcaktuar në mënyrë të shprehur çështjet për të cilat duhet të vendosë mbledhja plenare, por ne nuk kemi ende një rregullore për lëndën për çdo

Komision, për këtë arsye edhe pse nuk parashikohet në dispozitën e nenit 61 kompetenca e mbledhjes plenare për të vendosur për lejet e papaguara, e sollëm për miratim në mbledhje plenare.

Duke qenë një akt administrativ individual, hyrja e tij është në fuqi menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të Këshillit. Njëkohësisht në kuadër të ndryshimit të ligjit, e drejta e ankimit ndaj vendimit të refuzimit është në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga momenti i njoftimit të vendimit të arsyetuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Nëse keni ndonjë diskutim.

Atëherë, kalojmë për vendimmarrje projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Refuzimin e kërkesës së zonjës {...}, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për dhënien e lejes së papaguar për periudhën 7 dhjetor 2019 deri në 30 prill 2020. 2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 2 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.12.2019)

Pika 3 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në disa gjykata të qarkut Tiranë, Durrës dhe Lezhë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Klement Ngreca, Drejtor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

3 (Pikë shtesë). Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në disa gjykata të qarkut Tiranë, Durrës dhe Lezhë”.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës e cila ka të bëjë me rifillimin e veprimtarive dhe shërbimeve gjyqësore për disa gjykata.

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas situatës emergjente të krijuar në qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë (*lapsus “Vlorë”, bëhet fjalë për Lezhën*), në datë 2 dhjetor 2019 mori vendimin nr. 267 për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat që përfshihen në këto qarqe, deri në një moment kur të kishim një akt konstatimi nga autoritetet përgjegjëse që do të na garantonin lidhur me sigurinë e godinave në të cilat ushtrohet aktiviteti gjyqësor (veprimtarisë gjyqësore). Nga puna dhe nga informacionet e ardhura pranë Këshillit nga një pjesë e gjykatave, konstatohet që për një pjesë të mirë të gjykatave që janë pjesë e këtyre qarqeve, konkretisht Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (përfshirë dhomën penale dhe civile), Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, janë administruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor

aktet e konstatimit të lëshuara nga autoriteti përgjegjës, në të cilat përcaktohet që këto godina ofrojnë standardet e sigurimit për të zhvilluar veprimtarinë e tyre.

Për këtë rrjedhje, akti që i propozojmë Këshillit është që në situatën që shkaku për të cilin kishim kërkuar pezullimin e veprimtarisë gjyqësore ka rënë për këto gjykata, atëherë të lejoj nëpërmjet një vendimi të Këshillit rifillimin e veprimtarisë për këto gjykata.

Jeni dakord me propozimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në datën 05.12.2019 për disa gjykata të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarkun Tiranë, Durrës dhe Lezhë, si më poshtë: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhoma penale dhe civile); Gjykatën e Apelit Tiranë; Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 04.12.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.*

RENDI I DITËS:

4. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin e tyre të përhershëm, projekt-akt i cili është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do të raportohet nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda janë paraqitur dy kërkesa, paraqitet nevojë në 2 çështje penale. Në të dy rastet kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Lidhur me kërkesën e paraqitur, zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit është i pamundur për shkak të padisponueshmërisë, mungesës së gjyqtarëve në skemë delegimi. Po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, pavarësisht faktit se në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda ka 5 pozicione të lira të përkohshme, referuar nevojës që paraqet në këtë rast gjykata, çka do të bënte që transferimi i përkohshëm i të paktën 1 gjyqtari do të sillte jo efektivitet në gjykatat nga ai duhet të transferohet përkohësisht. Për rrjedhojë bëhet i zbatueshëm

mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër të ndryshme, nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar vendimit përkatës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në konsideratë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon, gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë të gjitha gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, për çështjen nr. 1 dhe, Gjykata e Apelit Tiranë për çështjen nr. 2. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 gjyqtarë.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon, për çështjen nr. 1, në kushtet kur nevojat e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda është trajtuar në disa raste edhe më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Komisioni bën të njëjtat propozime, të pranuar më parë nga Këshilli, në lidhje me gjykatën nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje, pikërisht të gjitha gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje, pikërisht 1 gjyqtar.

Gjyqtarët që duhet të përjashtohen nga shorti që janë kryetarët apo kryetarët në detyrë të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht gjyqtarët {...} ... {...}; Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}; gjyqtarët që u është akorduar leja afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}; dhe gjyqtarët që sipas informacioneve publike janë nën procedim penal përpara juridiksionit të gjykatave të krimeve të rënda, domethënë edhe të gjykatës në nevojë, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Komisioni ka edhe disa propozime të bëra rishtazi, të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht gjyqtarja {...}. Po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë që ka pengesë ligjore për gjykimin e çështjes, ndërsa është caktuar më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, por është përjashtuar nga gjykimi i çështjes, konkretisht gjyqtarja {...}. Po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarja e

Gjykatës së Apelit Shkodër që ka paraqitur dorëheqjen nga detyra, kërkesë e cila është në proces trajtimi, konkretisht gjyqtarja {...}.

Për çështjen nr. 2, Komisioni ka këto propozime. Për këtë çështje për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}; të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht gjyqtari {...}; të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që është anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht gjyqtari {...}; të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që u është akorduar leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}; të përjashtohen po ashtu gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin në 12 apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht gjyqtarët {...} ... {...} dhe; propozimi i fundit është që gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që mund të caktohet për gjykimin e çështjes nr. 1, të përjashtohet nga shorti për çështjen nr. 2.

Këto janë propozimet e Komisionit. Nëse jeni dakord, mund të procedojmë me shortin elektronik ose do të ndryshojmë/modifikojmë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë të gjithë dakord me propozimet.)

Kalojmë në hedhjen e shortit.

Ilir Toska: Atëherë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, duhet të vazhdojmë të procedojmë me shortin elektronik.

Atëherë, janë reflektuar të gjitha propozimet e Komisionit?

Mund të vazhdojmë me shortimin për çështjen nr. 1.

Valbona Bako: Gjyqtari i përzgjedhur është {...}.

Ilir Toska: Mirë! Për çështjen nr. 1, shorti elektronik përzgjedhi gjyqtarin {...}.

Vazhdojmë me shortimin për çështjen nr. 2.

Valbona Bako: Gjyqtari {...}.

Ilir Toska: Për çështjen nr. 2, shorti për zgjedhjen gjyqtarin {...}.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit. Faleminderit!

Naureta Llagami: Faleminderit!

Në qoftë se nuk keni ndonjë gjë për të diskutuar, mbledhjen e konsideroj të mbyllur. Faleminderit, për prezencën! Punë të mbarë!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor